



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic Of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina

---

Në bazë të nenit 11, paragrafi 1, nenit 18, paragrafi 1 dhe 3, nenit 20, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Komuna e Prishtinës, rishpallë këtë

## K O N K U R S PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

### KABINETI I KRYETARIT

**1. POZITA: Udhëheqës i personelit - një (1) ekzekutues**

**KOEFICIENTI : 9.5**

**LLOJI I POZITËS:** i karrierës

**POZITA FUNKSIONALE:** nëpunës civil i nivelit drejtues

**ORARI I PUNËS:** 40 orë në javë

**PËRGJEGJËSIA MBIKËQYRËSE :** po

**MBIKËQYRJA:** Kryetari i Komunës

**DETYRAT KRYESORE TË PUNËS :**

- Harton dhe publikon konkurset për plotësimin e vendeve të lira të punës;
- Cakton Komisionin intervistues për praninë të kandidatëve, të cilët kanë konkurruar në bazë të konkursit të shpallur;
- Bën emërimin e shërbyesve civilë në organin e punësimit;
- Përpilon formën e kontratës-akt emërimit dhe bën nënshkrimin e kontratave të punës-akt emërimeve;
- Inicon procedurën disiplinore ndaj shkelëseve të kodit të mirësjelljes;
- Kujdeset për të drejtat e të punësuarve në Shërbimin civil të Komunës, në pajtim me dispozitat që janë në fuqi, e që rregullojnë marrëdhënien e punës;
- Kryen edhe detyra të tjera, të cilat i caktohen nga autoriteti i Kryetarit të Komunës;
- Për punën e tij i përgjigjet Kryetarit të Komunës.

**Kushtet:** Përgatitja Superiore, Fakulteti Juridik dhe Fakultete tjera relevante, 5 vjet përvojë pune profesionale, njohja e punës me kompjuter e domosdoshme.

## Data e rishpalljes se Konkursit - 29.07.2015 deri me dt.12.08.2015

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në objektin e komunës së vjetër.

Në aplikacion duhet te ceket qartë titulli i vendit te punë dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet te jenë kopje dhe nuk kthehen.

“ Shërbimi Civil i Komunës është në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mirëpret aplikime nga meshkujt dhe femrat e të gjitha komuniteteve të Kosovës “

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes për pozitat e cekura më lart.

KPSHC (Komisioni përzgjedhës i shërbimit civil) duke u bazuar në nenin 25 paragrafi 1 të Rregullores NR. 02/2010 për procedurat e rekrutimit të shërbimit civil, mund të verifikoi me institucionet përkatëse vërtetësinë e të dhënave të sigurta nga kandidatët.

Pas përgatitjes së listës së ngushtë të kandidatëve, këtyre kandidatëve do të ju kërkohen kopjet e dokumenteve të vërtetuara nga organi kompetent(diploma dhe kontrata e punës ose vërtetimi i përvojës e punës) nëse ato nuk janë dorëzuar të vërtetuara.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit si dhe te shkruhet e-mail adresa e sakt.

Fletë aplikacionet e kandidatëve me dokumente të pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit, nuk do të merren në shqyrtim.

Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni me Njësinë e personelit, zyra nr. 40, në këtë nr. të telefonit 038 / 230 - 900 lokali 10 -70.